



www.trt.albanian.com

[Faqja Kryesore](#) [Rss](#) [Live](#)


SHTYPI TURK 27.07.2010

Më poshtë vijnë titujt e disa prej lajmeve kryesore të publikuara nga mediat e shkruara turke për ditën e martë:

Postuar më 27.07.2010 08:33:32 UTC

Përditësuar më 27.07.2010 08:38:11 UTC

Gazeta Haber Türk përcjell se mbrëmë erdhi në Ankara Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, Dejvid Kamerun. Në vijim të lajmit thuhet se Kamerun, i cili gjendet në Turqi për një vizitë zyrtare dyditore, shoqërohet nga Ministri britanik i Punëve të Jashtme, Uilliam Hog dhe një delegacion.

Në lajmin e titulluar "Vizitë strategjike nga Kryeministri anglez në Ankara", publikuar në të përditshmen Sabah, ardhja në Turqi e Kamerunit menjëherë pas turneut të tij në SHBA dhe BE, vlerësohet si një sinjal i rëndësishëm që Anglia i kushton Turqisë.

Ditorja Yeni Şafak shkruan se qeverisja e Iranit i paraqiti dje në Vjenë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA), Jukia Amano letrën e dytë lidhur me këmbimin bërthamor. Sipas artikullit në fjalë, përfaqësuesi i përhershëm i Iranit në IAEA, Ambasadori Ali Asker Sulltanije deklaroi se vendi i tij është gati të fillojë bisedimet me Grupin e Vjenës, që formohet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Rusia dhe Franca për shkëmbimin e uranimit të pasuruar. Sulltanije, pasi konfirmoi edhe një herë se programi bërthamor i vendit të tij është plotësisht paqësor, bëri të ditur se kërkojnë të marrin nga vendet e Grupit të Vjenës uranum të pasuruar për qëllime tërësisht humanitare, për ta përdorur atë në fushën e mjekësisë, njofton ditorja turke.

Nga ana tjetër, në vijim të artikullit, Yeni Şafak thekson se ndërkohë që Sulltanije bënte këto deklarata, Ministrat e Punëve të Jashtme të Bashkimit Evropian të mbledhur në Bruksel, miratuan edhe masat e reja detyruese kundër Iranit, të cilat ndalojnë investimet e reja në sektorin iranian të naftës dhe gazit natyror, si dhe mbështetjen teknike e transferimin e teknologjive në drejtim të këtij vendi. Bazuar në këtë lajm, Iranit do t'i aplikohen edhe kufizime si ndalim i hapjes së filialeve të reja për bankat dhe kompanitë e sigurimeve iraniane, madje edhe domosdoshmëri për marrjen e konfirmimit në transferimet e shumave të mëdha monetare.

Gazeta Star, në shkrimin e saj që mban titullin "Festivali turk në Kanada", bën të ditur se këtë vit në edicionin IV të Festivalit Turk në Otava, organizuar nga Fondacioni i Kulturës Turke në Kanada, kanë marrë pjesë rreth 25 mijë vetë. Në rreshtat e saj lidhur me këtë lajm, Star citon Ministrin e Transportit të Kanadasë, Xhon Beird, i cili ishte i pranishëm në receptionin e dhënë në Bashkinë e Otavës, të ketë falënderuar organizatorët e festivalit me këto fjalë: "Ju turqit i shtoni shumë larmi këtij vendi. Edhe ndihmësi im është turk. Ju falënderoj të gjithëve."

"Norma e shfrytëzimit të kapacitetit në industri arrin sërish majat në korrik", është ky titulli që tërheq vëmendjen në faqet ekonomike të së përditshmes Zaman, e cila u kushton vend normave të publikuara nga Banka Qendrore e Turqisë për shfrytëzimin e kapacitetit në muajin korrik. Bazuar në shifrat e Bankës Qendrore, norma e përgjithshme e përdorimit të kapacitetit në industrinë e prodhimit për korrikun, në krahasim me të njëjtin muaj të vitit të kaluar, është rritur me 7,3 pikë duke arritur në 74,7%.

Gazeta Hürriyet njofton se Linjat Ajrore Turke (THY) kanë nënshkruar marrëveshje 10-vjeçare, 5 prej të cilëve janë opcional, për të drejtën e sponsorit të emrit me Euroleague Basketball, organizimin më të madh evropian të basketbollit. Me anë të kësaj marrëveshje, duke filluar nga sezoni i ardhshëm sfidat e Euroligës do të luhen në emrin 'Turkish Airlines Euroleague Basketball', bën të ditur Hürriyet dhe citon Presidentin e Bordit Drejtues të Euroleague Basketball, Jordi Bertomeu të jetë shprehur kështu: "Duke marrë parasysh forcën që marka e THY-së do t'i shtojë Euroligës, kemi arritur një model partneriteti të integruar."

Lajmet e Fundit

Terrori në fokus të strategjisë së re të NATO-s

Rritet tensioni në Bregun Perëndimor

Stamboll - Përfundojnë punimet e mbledhjes së 26-të të

ISEDAK-ut

Në Pakistan dicien 30 autobote

Kategori

- TURQIA
- RAJONI
- BOTA
- ARTI & KULTURA
- EKONOMIA
- SPORTI

Gjuhët

[Bosanski](#)
[Elliçkçî](#)
[English](#)
[Español](#)
[Italiano](#)
[Magyarország](#)
[تۆرکجه](#)
[Uyghuiche](#)
[تۆرکجه](#)

Fotogaleri



Pamje nga jeta e përditshme 21



Fotot e javës së 36-të (6-12 shtator 2010)



Fotot e javës së 35-të (30 gusht - 5 shtator 2010)

Videolajm



Numërimi i popullsisë në Maqedoni



Autokolona e ndihmave për Gazën në Turqi



Përfundoi restaurimi i hotelit historik "Pera Palas" në Stamboll